

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SMART CONSULTANCE SERVICES “ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 03.06.2024, ne te nenshkruarit:

1. **Arlind Boshku** i datëlindjes 07.07.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi I50707073E
2. **Neritan Golja** i datëlindjes 17.08.1973, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi H30817087M

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“SMART CONSULTANCE SERVICES “ SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit,Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Durres Lagjja 3, Rruga Ramazan Jella, Zona Kadastrale 8514, Godine me Nr.Pasurie 3/569.

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Zhvillimin e aktivitetit konsulencës, në fushën e marrëdhënieve të punës, juridike si dhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë. Akt ekspertize mbi aksidentet në punë. Shërbime për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kurse dhe trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë. Inspektim, mbikqyrje, supervizim për punën e kryer nga subjektet për sigurinë dhe shëndetin në punë. Përgatitje dhe hartim të dokumentave të vlerësimit të rrezikut në të gjitha fushat. Konsulencë dhe shërbime në fushën e shëndetit në punë në kompanitë private dhe shtetërore nëpërmjet profesionit të mjekut të punës apo mjekut të ndërrmarrjes. Organizimi i mbrojtjes kolektive dhe individuale, sigurimi i organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshëm, informimi, këshillimi dhe trajnimi profesional i punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, dhënia e këshillimit etj. Ofron Shërbimet e Jashtme të Specializuara për Parandalimin dhe Mbrojtjen në Punë, a) siguria në Punë; b) mjekësia e punës; c) ergonomia; d) higjena industriale, e) aspektet psikosociale të punës, përfshirë edhe dhunën dhe ngacmimin seksual në punë f) mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë. Studimi, hartimi dhe përgatitja e Projekteve mbi masat e Mbrojtjes nga Zjarri të Ndërtesave të çdo lloji. Hartimi i Akteve të Ekspertizës Teknike për Zjarret e Rëna. Dhënia e Asistencës Teknike dhe Trajnimi i punonjësve për masat e PMNZSH (përfshirë punonjësit e PMNZSH-së). Inspektim, mbikqyrje, supervizim për punën e kryer nga subjektet për mbrojtjen nga zjarri. Tregtim të mjeteve mbrojtëse individuale në punë. Tregtim të mjeteve

të shuarjes së zjarrit dhe aksesorëve të ndryshëm. Eksport - import të mjeteve të mbrojtjes në punë dhe mjeteve të shuarjes së zjarrit. Projektme dhe zbatime të ndërtimeve të konstruksioneve metalike, shkallë emergjence e të tjera. Zhvillimi i Planeve të Sigurisë dhe Koordinimit, Planeve të Ndhmës së Parë dhe evakuimit. Plani i Sigurisë Operacionale. Asistencë dhe Konsulencë për Aktivitetet e Koordinimit për Projektimin dhe Kryerjen e Punës së Sigurisë për Vendet e Ndërtimit Publik dhe Privat. Çertifikim mbi Menaxhimin e rrezikut dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit të kompanive sipas standarteve ISO9001, ISO14001, SA8000, OHSAS 18001 etj. Ekspertizë, analizë e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP). Kurse të formimit profesional për sigurinë dhe shëndetin në punë (Dëshmi dhe Çertifikata) sipas tipologjive: Mbrojtje nga zjarri emergjencat dhe evakuimin, Ndhma e parë mjekësore, Formim i punëmarrësve për sigurinë dhe shëndetin në punë, Këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë, Person përgjegjës dhe specialist për sigurinë në punë, Drejtues të sigurisë aziendale, siguria në punë në ndërtim. Formim për sigurinë në punë në sektorin mekanik bujqësor. Formim i instruktorëve të formimit profesional për sigurinë në punë, Formim mbi sigurinë në punë për pajisje dhe makineri industriale, mekanike bujqësore (motopirun, platforma lëvizëse, vinça teleskopik, vinça ure, skela, pompa betoni, suvatimi, makineri bujqësore, etj) që nuk klasifikohen si mjete të qarkullimit rrugor, transport mallrash të rrezikshëm (ADR). Formim mbi sigurinë në punë në sektorin hekurudhor, miniera, tunele, karriera, ujësjellëskanalizime, elektrik, Oshee, portual, aeroportual, hidro energjetik, ndërtim etj. Formim mbi administrimin e ndërtesave të përbashkëta të banimit, Formim mbi

menaxhimin e burimeve njerëzore, asistente zyre. Agjensi profesionale e rekrutimi për punësim, e cila ofron shërbime profesionale të burimeve njerëzore, trajnim, këshillim karriere etj. Kurse të Formim Profesional për : Mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis, për "Person Përgjegjës H.S.E (Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin)", për "Manovrues/Drejtuës Vinci Kulle", për "Person përgjegjës për rrezikun elektrik".

Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejuar për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **10.000 (dhjetemije)** Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Arlind Boshku, është zotëruar i 1 kuote, me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 5.000 leke.

Neritan Golja, është zotëruar e 1 kuote, me 50 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 5.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Kridja Maria Prifti** e datëlindjes 01.04.1968, lindur në Durrës, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

me numër identifikimi I65401091U, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë Statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

Arlind BOSHKU

Arlind Bosku


Neritan GOLJA

Neritan Golja
